<p>2.5. Menaxhon me skemat e përfitimeve në para të gatshme për familjet e varfra dhe kompensimet për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara shtesat për fëmijët, pagesat për lehona dhe përfitimeve tjera sociale, sipas kërkesave të Ministrisë;</p> <p>2.6. Planifikon buxhetin për financimin e skemave, programeve dhe shërbimeve që menaxhohen nga Departamenti;</p> <p>2.7. Zhvillon kornizën e indikatorëve për mbledhjen e të dhënave statistikore për fushën e politikave sociale dhe të mirëqenies sociale.</p> <p>2.8. Merr pjesë në ngritjen e kapaciteteve për shërbimet sociale dhe harton programe të këshillimit/mentorimit, për institucionet e përkujdesjes sociale dhe profesionistët e punës sociale;</p> <p>2.9. Bashkëpunon me palët e interesuara për avancimin dhe ngritjen profesionale dhe kapacitetet e stafit të ofruesve publikë dhe joqeveritarë në fushën e politikave të skemave sociale dhe mirëqenies sociale në përgjithësi;</p>	<p>2.5. Manages cash benefit schemes for poor families and compensations for families with children with disabilities, child allowances, maternity payments and other social benefits, according to the Ministry's requirements;</p> <p>2.6. Plans the budget for the financing of schemes, programs and services managed by the Department;</p> <p>2.7. Develops the framework of indicators for the collection of statistical data for the field of social policies and social welfare;</p> <p>2.8. Participates in capacity building for social services for social services and designing counselling/mentoring programmes for social care institutions and social work professionals;</p> <p>2.9. Cooperating with stakeholders for the advancement and professional capacity building of staff of public and non-governmental service providers, in the field of social schemes policies and social welfare in general; and</p>	<p>2.5. Upravlja šemama novčanih davanja za siromašne porodice i naknadama za porodice sa decom sa smetnjama u razvoju, dečijim dodacima, porodijskim i drugim socijalnim davanjima, u skladu sa zahtevima Ministarstva;</p> <p>2.6. Planira budžet za finansiranje šema, programa i usluga kojima upravlja odeljenje;</p> <p>2.7. Razvija okvir indikatora za prikupljanje statističkih podataka za oblast socijalne politike i socijalne zaštite;</p> <p>2.8. Učestvuje u izgradnji kapaciteta za socijalne usluge i osmišljava programe savetovanja/mentorstva za ustanove socijalne zaštite i stručnjake za socijalni rad;</p> <p>2.9. Sarađuje sa zainteresovanim stranama na unapređenju i stručnom usavršavanju i kadrovskim kapacitetima javnih i nevladinih pružalaca, u oblasti politika socijalnih šema i socijalne zaštite uopšte; i</p>
---	---	--

<p>2.10. Shqyrton raportet vjetore të drejtorive përkatëse komunale dhe planeve vjetore të punës së tyre për fushën e politikave të skemave sociale.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit të Skemave Sociale, raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:</p> <p>4.1. Divizioni për Politika të Skemave Sociale;</p> <p>4.2. Divizioni për Ndihma Sociale; dhe</p> <p>4.3. Divizioni për Përfitime Sociale;</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Skemave Sociale është njëzet e një (21).</p>	<p>2.10. Reviewing the annual reports of the respective municipal directorates and approving the annual work plans for the field of social schemes policies.</p> <p>3. The Director of the Social Schemes Department shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Social Policy Division;</p> <p>4.2. Social Assistance Division;</p> <p>4.3. Social Benefits Division; and</p> <p>5. The number of employees in the Social Schemes Department shall be twenty one (21).</p>	<p>2.10. Razmatra godišnje izveštaje relevantnih opštinskih direkcija i njihove godišnje planove rada za oblast politika socijalnih šema.</p> <p>3. Direktor Odeljenje za socijalne šeme podnosi izveštaj generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za socijalnu politiku;</p> <p>4.2. Odsek za socijalnu pomoć;</p> <p>4.3. Odsek za socijalna davanja; i</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenje za socijalne šeme je dvadeset jedan (21).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Divizioni për Politika të Skemave Sociale</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Politika të Skemave Sociale janë:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>Social Schemes Policy Division</b></p> <p>1. The duties and responsibilities of the Social Schemes Policy Division shall be:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Odsek za politiku socijalnih šema</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za politiku socijalne šeme su:</p>

<p>1.1. Harton dhe zhvillon programet, strategjitë në fushën e politikave sociale dhe mirëqenies sociale në përgjithësi;</p> <p>1.2. Përgatit analiza dhe kryen hulumtime në fushën e mirëqenies sociale dhe përfshirjes sociale;</p> <p>1.3. Përgatit vlerësim dhe ofron rekomandime për fushën e politikave të skemave sociale, për strukturat relevante në nivelin qendror apo lokal;</p> <p>1.4. Koordinon aktivitetet me Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe subjektet e tjera për sigurimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, të cilat përdoren për publikimin e raporteve hulumtuese;</p> <p>1.5. Përgatit raporte dhe statistika për realizimin e objektivave dhe aktivitetëve në fushën e politikave të skemave sociale, përfshirjes sociale dhe mirëqenies sociale.</p>	<p>1.1. Designs and develops programs, strategies in the field of social schemes policies and social welfare in general;</p> <p>1.2. Prepares analyzes and conducts research in the field of social welfare and social inclusion and social services;</p> <p>1.3. Prepares evaluation and offers recommendations for the field of social schemes policies, for relevant structures at the central or local level;</p> <p>1.4.Coordinates activities with the Statistics Agency of Kosovo and other entities for the provision of data and their processing, which are used for the publication of research reports;</p> <p>1.5. Prepare reports and statistics for the realization of objectives and activities in the field of social schemes policies, social inclusion and social welfare in general.</p>	<p>1.1.Osmišljava i razvija programe, strategije u oblasti socijalne politike i socijalne zaštite uopšte;</p> <p>1.2. Priprema analize i sprovodi istraživanja u oblasti socijalne dobrobiti i socijalne uključenosti;</p> <p>1.3. Priprema evaluaciju i nudi preporuke za oblast socijalne šeme, za relevantne strukture na centralnom ili lokalnom nivou;</p> <p>1.4.Koordinira aktivnosti sa Agencijom za statistiku Kosova i drugim subjektima za obezbeđivanje podataka i njihovu obradu, koji se koriste za objavljivanje istraživačkih izveštaja;</p> <p>1.5. Priprema izveštaje i statistike za realizaciju ciljeva i aktivnosti u oblasti socijalne politike i socijalne inkluzije;</p>
---	--	--



<p>1.6. Harton dhe zhvillon doracakët dhe udhëzuesit e ndryshëm në fushëveprimin e politikave të skemave sociale;</p> <p>1.7. Bashkëpunon me strukturat profesionale vendore dhe të jashtme, me qëllim të ngritjes së kualitetit të shërbimeve në fushën e politikave të skemave sociale dhe mirëqenies sociale;</p> <p>1.8. Monitoron zbatimin e dokumenteve të politikave të skemave sociale dhe strategjive në fushën e mirëqenies sociale; dhe</p> <p>1.9. Identifikon dhe planifikon nevojat për financim nga fondet e BE-së dhe donatorët e për zhvillimin e sektorit të politikave të skemave sociale dhe të mirëqenies sociale;</p> <p>.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Politika të Skemave Sociale, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Politika të Skemave Sociale, është gjashtë (6).</p>	<p>1.6. Drafts and develops various manuals and guides in the scope of social schemes policies;</p> <p>1.7. Cooperates with local and external professional structures, with the aim of raising the quality of services in the field of social schemes policies and social welfare;</p> <p>1.8. Monitors the implementation of social schemes policy documents and strategies in the field of social welfare;</p> <p>1.9. Identifies and plans funding needs from EU funds and donors for the development of the social schemes policies and social welfare sector; and</p> <p>2. The Head of the Social Schemes Policy Division shall report to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Social Schemes Policy Division shall be six (6).</p>	<p>1.6. Dizajnira i razvija različite priručnike i vodiče u obimu politike socijalne šeme;</p> <p>1.7. Sarađuje sa lokalnim i spoljnim profesionalnim strukturama, u cilju postavljanja kvaliteta usluga u oblasti politika socijalnih shema i socijalne zaštite;</p> <p>1.8. Prati sprovođenje dokumenata i strategija socijalne šeme u oblasti socijalne zaštite; i</p> <p>1.9. Identifikuje i planira potrebe za finansiranjem iz fondova EU i donatora za razvoj socijalne šeme i sektora politike socijalne zaštite;</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za socijalnu politiku izveštava direktoru Odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za socijalnu politiku je šest (6).</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 50</b> <b>Divizioni për Ndhim Sociale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 50</b> <b>Social Assistance Division</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 50</b> <b>Odsek za socijalnu pomoć</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Ndhim Sociale, janë:</p> <p>1.1. Harton dhe zbaton dokumentet e politikave dhe programeve për ndihma sociale;</p> <p>1.2. Grumbullon, analizon dhe raporton mbi të dhënat për varfërinë në Kosovë dhe bashkëpunon me Agjencinë e Statistikave të Kosovës për publikimin e tyre;</p> <p>1.3. Zhvillon dhe siguron zbatimin e legjislacionit për ndihmë sociale dhe programet e Qeverisë për mbështetjen e familjeve të varfra dhe kategorive tjera të cënueshme;</p> <p>1.4. Koordinon aktivitetet me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, për zbatimin e programeve dhe masave të aprovuara nga Ministria dhe Qeveria;</p>	<p>1. The duties and responsibilities of the Social Assistance Division shall be:</p> <p>1.1. Drafting and implementing policy documents and programmes on social assistance;</p> <p>1.2. Collecting, analyzing and reporting the data on poverty in Kosovo and cooperating with the Kosovo Agency of Statistics for their publication;</p> <p>1.3. Developing and ensuring the implementation of social assistance legislation and government programmes to support poor families and other vulnerable categories;</p> <p>1.4. Coordinating activities with central and local level institutions for the implementation of programmes and measures approved by the Ministry and the Government;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za socijalnu pomoć su:</p> <p>1.1. Izrađuje i sprovodi dokumente politike i programe socijalne pomoći;</p> <p>1.2. Prikuplja, analizira i izveštava podatke o siromaštvu na Kosovu i saraduje sa Kosovskom agencijom za statistiku za njihovo objavljivanje;</p> <p>1.3. Razvija i obezbeđuje sprovođenje zakona o socijalnoj pomoći i vladinih programa za podršku siromašnim porodicama i drugim ugroženim kategorijama;</p> <p>1.4. Koordinira aktivnosti sa institucijama na centralnom i lokalnom nivou za sprovođenje programa i mera odobrenih od strane Ministarstva i Vlade;</p>

<p>1.5. Planifikon buxhetin për programin e ndihmave sociale dhe përgatitjen e raporteve për pagesat e realizuara nga programi i ndihmave sociale;</p> <p>1.6. Monitoron procesin e pagesave nga skema e ndihmave sociale dhe hartimi i raporteve të rregullta periodike;</p> <p>1.7. Bashkëpunon me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e aktiviteteve që ofrojnë mbështetje për grupet e cënueshme;</p> <p>1.8. Menaxhon dhe mirëmban të dhëna për aplikuesit dhe përfituesit e skemës së ndihmës sociale dhe pagesave sociale; dhe</p> <p>1.9. Menaxhon bazën e të dhënave të ndihmave sociale dhe regjistrin social, për zbatimin e testit të varfërisë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit të Ndhimave Sociale, raporton te Drejtori i Departamentit.</p>	<p>1.5. Planning the budget for the social assistance programme and preparing reports on the payments made by the social assistance programme;</p> <p>1.6. Monitoring payment process from the social assistance scheme and compiling regular periodic reports;</p> <p>1.7. Cooperating with local and international non-governmental organizations to carry out activities that provide support to vulnerable groups;</p> <p>1.8. Managing and maintaining data on applicants and beneficiaries of the social assistance and social payment scheme; and</p> <p>1.9. Managing the social assistance database and the social register for the implementation of the poverty test.</p> <p>2. The Head of the Social Assistance Division shall report to the Director of the Department.</p>	<p>1.5. Planira budžet programa socijalne pomoći i priprema izveštaje o izvršenim uplatama po programu socijalne pomoći;</p> <p>1.6. Prati proces isplate iz šeme socijalne pomoći i sastavlja redovne periodične izveštaje;</p> <p>1.7. Sarađuje sa lokalnim i međunarodnim nevladinim organizacijama na razvoju aktivnosti koje pružaju podršku ugroženim grupama;</p> <p>1.8. Upravlja i održava podatke o podnosiocima zahteva i korisnicima šeme socijalne pomoći i socijalnih plaćanja; i</p> <p>1.9. Vodi bazu podataka socijalne pomoći i socijalni registar za sprovođenje testa siromaštva.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za socijalnu pomoć izveštava direktoru Odeljenja.</p>
---	---	--

<p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Ndhim Social, është tetë (8).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Divizioni për Përfitimet Sociale</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Përfitime Sociale, janë:</p> <p>1.1. Implementon politikat dhe programet për përfitimet sociale për lehon, shtesa për fëmijë dhe përfitimet të tjera sociale që caktohen me akte normative të Qeverisë apo Ministrit;</p> <p>1.2. Siguron zbatimin e legjislacionit për përfitimet sociale për lehon, shtesa për fëmijë dhe përfitimet të tjera sociale;</p> <p>1.3. Grumbullon, analizon dhe raporton të dhënat për përfitimet sociale për lehon, shtesa për fëmijë dhe përfitimet të tjera sociale;</p> <p>1.4. Kujdeset në finalizimin e pagesave të përfitimet sociale për lehon, shtesa për fëmijë dhe përfitimet të tjera sociale;</p>	<p>3. The number of employees in the Social Assistance Division shall be eight (8).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>Division for Social Benefits</b></p> <p>1. The duties and responsibilities of the Division for Social Benefits are:</p> <p>1.1. Implements policies and programs for social benefits for maternity, child allowances and other social benefits that are determined by normative acts of the Government or the Minister;</p> <p>1.2. Ensures the implementation of legislation on social benefits for maternity, child allowances and other social benefits;</p> <p>1.3. Collects, analyzes and reports data on social benefits for maternity, child benefits and other social benefits;</p> <p>1.4. Cares in the finalization of payments of social benefits for maternity, allowances for children and other social benefits;</p>	<p>3. Broj zaposlenih u Odseku za socijalnu pomoć je osam (8).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 51</b> <b>Odsek za socijalna davanja</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za socijalna davanja su:</p> <p>1.1. Sprovodi politike i programe socijalnih davanja za porođilje, dečiji dodatak i druga socijalna davanja, utvrđeno normativnim aktima Vlade ili ministra;</p> <p>1.2. Osigurava primenu zakona o socijalnim davanjima za porođilje, dečiji dodatak i druga socijalna davanja;</p> <p>1.3. Prikuplja, analizira i podnosi izveštaje sa podacima o socijalnim davanjima za porođilje, dečiji dodatak i druga socijalna davanja;</p> <p>1.4. Brine se o okončanju isplata socijalnih davanja za porođilje, dečijih dodataka i drugih socijalnih davanja;</p>
---	--	--

<p>1.5. Koordinon aktivitetet që kanë për qëllim përmirësimin e procesin të regjistrimit, aplikimit dhe përfitimit të programit për lehona, shtesa për fëmijë dhe përfitimet të tjera sociale.</p> <p>1.6. Koordinon aktivitetet me departamentin përkatës të TI dhe institucionet qeveritare për TI lidhur me sistemet elektronike përmes të cilit mundësohet implementimi i përfitimeve sociale.</p> <p>1.7. Përmes qendrës së thirrjeve (tavolina ndihmëse), ofron këshillimet e nevojshme për qytetarët që kanë nevojë për informata lidhur me aplikimin dhe përfitimet sociale për lehona, shtesa për fëmijë dhe përfitimet tjera sociale.</p> <p>1.8. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me Qendrat për Punë Sociale, për zbatimin e skemës së përkrahjes së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar; dhe</p> <p>1.9. Menaxhon dhe mirëmban të dhëna për aplikuesit dhe përfituesit e skemës</p>	<p>1.5. Coordinates activities aimed at improving the process of registration, application and benefits of the program for maternity, child benefits and other social benefits.</p> <p>1.6. Coordinates activities with the relevant IT department and government institutions for IT related to electronic systems through which the implementation of social benefits is enabled.</p> <p>1.7. Through the call center (help desk), it offers the necessary advice to citizens who need information regarding the application and social benefits for maternity, child benefits and other social benefits.</p> <p>1.8. Collaborates and coordinates activities with the Centers for Social Work, for the implementation of the support scheme for families with children with disabilities; and</p> <p>1.9. Manages and maintains data on applicants and beneficiaries of the</p>	<p>1.5. Rukovodi aktivnostima u cilju unapređenja procesa upisa i prijave korisnika programa porodiljskih, dečijih i drugih socijalnih davanja.</p> <p>1.6. Koordinira aktivnosti sa resornim IT odeljenjem i državnim institucijama za informatiku u vezi sa elektronskim sistemima preko kojih je omogućeno sprovođenje socijalnih davanja.</p> <p>1.7. Preko kontakt centra (služba za podršku) nudi neophodne savete građanima kojima su potrebne informacije u vezi sa prijavom i socijalnim beneficijama za porodilje, dečje i druga socijalna davanja.</p> <p>1.8. Sarađuje i koordinira aktivnosti sa Centrima za socijalni rad, na realizaciji šeme podrške porodicama sa decom sa smetnjama u razvoju; i</p> <p>1.9. Upravlja i održava podatke o podnosiocima zahteva i korisnicima</p>
--	--	--

<p>së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Përfitimet Sociale, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Përfitimet Sociale, është gjashtë (6).</p>	<p>scheme for families with children with disabilities.</p> <p>2. The Head of the Division for Social Benefits reports to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Social Benefits Division is six (6).</p>	<p>programa za porodice sa decom sa smetnjama u razvoju.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za socijalna davanja izveštava direktoru Odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za socijalna davanja je šest (6).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 52</b> <b>Departamenti i Pensioneve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 52</b> <b>Pension Department</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 52</b> <b>Odeljenje za penzije</b></p>
<p>1. Departamenti i Pensioneve ka për mision hartimin e politikave publike në realizimin e të drejtave në pensione dhe benefite të tjera nga sigurimi pensional dhe invalidor, përfshirë edhe kategoritë e dala nga lufta si dhe koordinimin dhe zbatimin e skemave pensionale të financuara nga shteti, përmes degëve lokale të saj.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Pensioneve, janë:</p> <p>2.1. Zhvillon politikat e sistemit pensional, invalidor, aftësisë së kufizuar dhe të kategorive të dala nga lufta;</p>	<p>1. The mission of the Pension Department shall be to draft public policies for the realization of pension rights and other benefits under the pension and disability social security, as well as the coordination and implementation of state-funded pension schemes through its local branches.</p> <p>2. The duties and responsibilities of the Pension Department shall be:</p> <p>2.1. Developing the policies on pension, invalid and disability systems, according to the applicable legislation;</p>	<p>1. Misija Odeljenja za penzije je izrada javnih politika u ostvarivanju penzijskih prava i drugih beneficija iz penzijskog i invalidskog socijalnog osiguranja, uključujući kategorije proistekle iz rata, kao i koordinacija i sprovođenje penzionih šema koje finansira država, preko svojih lokalnih organa.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za penzije:</p> <p>2.1. Razvija politike penzijskog i invalidskog sistema, za osobe sa ograničenim sposobnostima kao i za kategorije proistekle iz rata;</p>

<p>2.2.Zhvillon politikat e sistemit pensional në përputhje me standardet ndërkombëtare;</p> <p>2.3.Siguron sistem të qëndrueshëm afatgjatë pensional dhe invalidor, për siguri më të madhe ekonomike të përfituesve të të drejtave pensionale dhe invalidore, të aftësisë së kufizuar si dhe kategorive të dala nga lufta;</p> <p>2.4.Zhvillon analiza, projeksione financiare afatgjate dhe programe si bazë ekspertësh, për përcaktimin dhe zbatimin e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor;</p> <p>2.5. Mbikëqyr drejtpërdrejtë zbatimin e akteve normative në fushëveprimin e Departamentit, dhe punën e degeve lokale;</p> <p>2.6. Udhëheq me procedurat për kthimin e mjeteve të tërhequra për kohë gjatë së cilës përfitimi nga skema nuk është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.7. Administron skemat pensionale dhe invalidore përfshirë edhe skemat</p>	<p>2.2.Developing the policies on the pension and disability social security system in accordance with international standards;</p> <p>2.3.Providing a stable long-term pension and disability system for greater economic and social security of beneficiaries of pension, invalid and disability rights;</p> <p>2.4. Developing expert analysis, long-term financial projections and programmes on defining and implementing pension and disability policy;</p> <p>2.5.Supervising directly the implementation of normative acts within the scope of the Department, and the work of local branches;</p> <p>2.6. Conducting the procedures for the return of funds withdrawn by family members after the death of the pensioner;</p> <p>2.7. Administering pension and disability schemes defined by the relevant applicable legislation;</p>	<p>2.2.Razvija politike penzijskog i invalidskog sistema socijalnog osiguranja u skladu sa međunarodnim standardima;</p> <p>2.3.Obezbeđuje stabilan dugoročni penzijski i invalidski sistem za veću ekonomsku i socijalnu sigurnost korisnicima penzijskih i invalidskih prava, osobama sa ograničenim sposobnostima kao i kategorijama proisteklih iz rata;</p> <p>2.4.Izrađuje analize, dugoročne finansijske projekcije i programe kao stručnu osnovu za definisanje i sprovođenje politike penzijskog i invalidskog osiguranja;</p> <p>2.5.Neposredno nadzire sprovođenje normativnih akata iz delokruga Odeljenja i rad lokalnih organa;</p> <p>2.6. Vodi postupke za povraćaj sredstava koja su podigla članovi porodice nakon smrti penzionera;;</p> <p>2.7. Upravlja penzijskim i invalidskim planovima uključujući i penzijskom šemom za kategorije proistekle iz rata,</p>
---	---	--

<p>pensionale të kategorive të dala nga lufta, të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi;</p> <p>2.8. Koordinon planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit, për pensione dhe benefite të tjera;</p> <p>2.9. Menaxhon pagesat e pensioneve të përfituesve nga skemat pensionale dhe invalidore;</p> <p>2.10. Menaxhon dhe mirëmban regjistrat dhe statistikat për pagesat e pensioneve të përfituesve nga skemat pensionale dhe invalidore.</p> <p>2.11. Siguron zbatimin e procedurave për realizimin e të drejtave për pensione, për qytetarët e Kosovës që kanë punuar jashtë vendit dhe anasjelltas;</p> <p>2.12. Mirëmban dokumentacionin për të gjitha shpenzimet lidhur me shpërndarjen e pensioneve;</p> <p>2.13. Harton raportet e rregullta periodike nga fusha e pensioneve; dhe</p>	<p>2.8. Takes care to coordinate planning and managing the budget for pensions and other benefits;</p> <p>2.9. Managing the pension payments to pensioners;</p> <p>2.10. Managing and maintaining records and statistics on pension payments;</p> <p>2.11. Ensuring the implementation of procedures for the realization of pension rights for citizens of Kosovo who have worked abroad and vice versa;</p> <p>2.12. Maintaining documentation for all expenses related to the pension distribution;</p> <p>2.13. Compiling regular periodic reports in the area of pensions; and</p>	<p>definisane relevantnim zakonima na snazi;</p> <p>2.8. Koordinira planiranje i upravljanje budžetom za penzije i druga davanja;</p> <p>2.9. Upravlja isplatama penzija korisnicima penzijskih i invalidskih šema;</p> <p>2.10. Vodi i održava registre i statistiku za isplatu penzija korisnicima penzijskih i invalidskih šema;</p> <p>2.11. Obezbeđuje sprovođenje procedura za ostvarivanje prava na penziju za građane Kosova koji su radili u inostranstvu i obrnuto;</p> <p>2.12. Vodi dokumentaciju za sve troškove u vezi sa raspodelom penzija;</p> <p>2.13. Sastavlja redovne periodične izveštaje iz oblasti penzija; i</p>
--	--	---



<p>2.14. Monitoron zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit të Pensioneve, raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet, si në vijim:</p> <p>4.1. Divizioni për Politika Pensionale dhe Invalidore;</p> <p>4.2. Divizioni për Pensione të Jashtme; dhe</p> <p>4.3. Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale.</p> <p>4.4. Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale për Kategoritë e Luftës;</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Pensioneve, është dyzet (40).</p>	<p>2.14. Monitoring the implementation of strategies and action plans.</p> <p>3. The Director of the Pension Department shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Pension and Disability Policy Division;</p> <p>4.2. External Social Security and Pension Division; and</p> <p>4.3. Pension Scheme Administration Division.</p> <p>4.4. Division for Administration of Pension Schemes for War Categories;</p> <p>5. The number of employees in the Pension Department shall be forty (40).</p>	<p>2.14. Prati sprovodjenje strategija i akcionih planova;</p> <p>3. Direktor Odeljenja za penzije izveštava Generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za penzijsku i invalidsku politiku;</p> <p>4.2. Odsek za socijalno osiguranje i inostrane penzije; i</p> <p>4.3. Odsek za upravljanje penzijskim šemama;</p> <p>4.4. Odsek za upravljanje šemom za ratne kategorije;</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za penzije je četrdeset (40).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 53</b> <b>Divizioni për Politika Pensionale dhe Invalidore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 53</b> <b>Pension and Disability Policy Division</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 53</b> <b>Odsek za penzijsku i invalidsku politiku</b></p>

<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Politikën Pensionale dhe Invalidore, janë:</p> <p>1.1. Propozon dhe harton politikën për zhvillimin e sistemit pensional dhe invalidor, në përputhje me standardet ndërkombëtare;</p> <p>1.2. Monitoron dhe zbaton politikën e vendosura për funksionimin e sistemit të sigurimit pensional, invalidor, aftësisë së kufizuar dhe të kategorive të dala nga lufta;</p> <p>1.3. Përgatit analiza, raporte, informacione, studime dhe programe si bazë profesionale, për përcaktimin dhe zbatimin e politikës të pensioneve ;</p> <p>1.4. Kryen analiza të trendeve demografike, të tregut të punës dhe tregut të kapitalit në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, duke propozuar masa adekuate në fushën e politikës pensionale;</p> <p>1.5. Planifikon buxhetin për të gjitha skemat pensionale;</p>	<p>1. The duties and responsibilities of the Pension and Disability Policy Division shall be:</p> <p>1.1. Proposing and drafting policies for the development of the pension and disability system in accordance with international standards;</p> <p>1.2. Monitoring and implementing policies established for the functioning of pension, invalid and disability social security system;</p> <p>1.3. Preparing professional analyzes, reports, information, studies and programmes on defining and implementing pension and social security policy;</p> <p>1.4. Conducting analysis of demographic, labour market and capital market trends in the short, medium and long term, proposing adequate measures in the area of pension policy;</p> <p>1.5. Planning the budget for all pension schemes;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za penzijsku i invalidsku politiku:</p> <p>1.1. Predlaže i izrađuje politike za razvoj penzijsko i invalidskog sistema, u skladu sa međunarodnim standardima;</p> <p>1.2. Prati i sprovodi politike utvrđene za rad sistema penzijsko i invalidskog osiguranja, osiguranja osoba sa ograničenim sposobnostima i ratnim kategorijama;</p> <p>1.3. Priprema analize, izveštaje, informacije, studije i programe kao stručnu osnovu za definisanje i sprovođenje politike penzijskog i socijalnog osiguranja;</p> <p>1.4. Vršiti analize demografskih kretanja, kretanja tržišta rada i tržišta kapitala u kratkoročnom, srednjem i dugoročnom periodu, predlaganjem adekvatnih mera u oblasti polise penzijskog osiguranja;</p> <p>1.5. Planira budžet za sve penzione šeme;</p>
--	---	---

<p>1.6. Përgatit analiza dhe raporte të rregullta në fushën e pensioneve; dhe</p> <p>1.7. Ofron rekomandime organit vendimmarrës rreth përcaktimit të vlerës së pensioneve, përshtatshmërisht me koston e jetesës në Kosovë;</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Politika Pensionale dhe Invalidore, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Politika Pensionale dhe Invalidore, është pesë (5).</p>	<p>1.6. Preparing regular analyzes and reports in the area of pensions; and</p> <p>1.7. Proposing the determination of the value of pensions against the cost of living in Kosovo;</p> <p>2. The Head of the Pension and Disability Policy Division shall report to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Pension and Disability Policy Division shall be five (5).</p>	<p>1.6. Priprema redovne analize i izveštaje iz oblasti penzija; i</p> <p>1.7. Obezbeđuje preporuke organu prilikom donošenja odluka o određivanju vrednosti penzije, srazmerno troškovima života na Kosovu;</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za penzijsku i invalidsku politiku izveštava direktoru Odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za penzijsku i invalidsku politiku je pet (5).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 54</b> <b>Divizioni për Pensione të Jashtme</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 54</b> <b>Foreign Pensions Division</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 54</b> <b>Odsek za inostrane penzije</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Pensione të Jashtme, janë:</p> <p>1.1. Siguron zbatimin e politikave për realizimin e të drejtës së pensioneve jashtë shtetit;</p> <p>1.2. Siguron zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale nga fusha e sigurime sociale;</p>	<p>1. The duties and responsibilities of the Foreign Pension Division shall be:</p> <p>1.1. Ensuring the implementation of policies on the realization of the pension right abroad;</p> <p>1.2. Ensuring the implementation of bilateral and multilateral agreements in the area of social security;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za inostrane penzije:</p> <p>1.1. Obezbeđuje sprovođenje politika za ostvarivanje prava na penzije u inostranstvu;</p> <p>1.2. Obezbeđuje sprovođenje bilateralnih i multilateralnih sporazuma iz oblasti socijalnog osiguranja;</p>

<p>1.3. Siguron zbatimin e legjislacionit relevant ndërkombëtar dhe zbatimin e procedurave për pensionet e jashtme, për pensione që ndërlihet me punësimin jashtë dhe brenda vendit;</p> <p>1.4. Siguron informatat për procedurat që duhet të ndiqen për aplikim;</p> <p>1.5. Siguron zbatimin e standardeve të përfshirjes së pensioneve të jashtme në skemat pensionale;</p> <p>1.6. Propozon dhe merr pjesë në hartimin e marrëveshjeve bilaterale të sigurime sociale;</p> <p>1.7. Përgatit analiza dhe raporte të rregullta periodike në fushën e pensioneve të jashtme;</p> <p>1.8. Përgatit informata dhe siguron formularët e nevojshëm për realizimin e kërkesave për të gjitha llojet e pensioneve për qytetarët e Kosovës që përkohësisht kanë punuar jashtë vendit, si dhe të huajt që kanë punuar në Kosovë, në harmoni me marrëveshjet në fuqi;</p>	<p>1.3. Ensuring the implementation of relevant international legislation and the implementation of procedures on external pensions for pensions related to employment abroad and domestically;</p> <p>1.4. Providing information on the procedures to be followed for application;</p> <p>1.5. Ensuring the implementation of standards for the inclusion of external pensions in pension schemes;</p> <p>1.6. Proposing and taking part in drafting the bilateral social security agreements;</p> <p>1.7. Preparing regular analyzes and reports in the area of external pension;</p> <p>1.8. Preparing information and providing the necessary forms for the realization of applications for all types of pensions for citizens of Kosovo who have temporarily worked abroad, as well as foreigners who have worked in</p>	<p>1.3. Obezbeđuje sprovođenje relevantnog međunarodnog zakonodavstva i sprovođenje procedura za inostrane penzije, za penzije u vezi sa zapošljavanjem u inostranstvu i u zemlji;</p> <p>1.4. Pruža informacije o procedurama koje treba pratiti za prijavu;</p> <p>1.5. Obezbeđuje primenu standarda za uključivanje inostranih penzija u penzijske šeme;</p> <p>1.6. Predlaže i učestvuje u izradi bilateralnih sporazuma o socijalnom osiguranju;</p> <p>1.7. Priprema analize i redovne periodične izveštaje iz oblasti inostranih penzija;</p> <p>1.8. Priprema informacije i obezbeđuje potrebne obrasce za realizaciju zahteva za sve vrste penzija za državljane Kosova koji su privremeno radili u inostranstvu, kao i za strance koji su radili na Kosovu, u skladu sa sporazumima na snazi;</p>
--	---	---

<p>1.9. Verifikon dhe siguron unifikimin e stazhit pensional të punës, për të siguruarit kosovarë që kanë punuar jashtë vendit dhe të huajt që kanë punuar në Kosovë;</p> <p>1.10. Zhvillon procedurat lidhur për kthimin e mbi-pagesave dhe përfitimeve të pensioneve; dhe</p> <p>1.11. Inicion procedurat për realizimin e të drejtës në pension të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, konform marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të sigurime sociale.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Pensione të Jashtme, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Pensione të Jashtme, është njëmbëdhjetë (11).</p>	<p>Kosovo, in accordance with the applicable agreements;</p> <p>1.9. Verifying and ensuring the unification of retirement work experience for Kosovo insured who have worked abroad and foreigners who have worked in Kosovo;</p> <p>1.10. Developing procedures related to the return of over payments and pension benefits; and</p> <p>1.11. Initiating the procedures for the realization of the pension right defined by the applicable legislation in accordance with bilateral and multilateral social security agreements.</p> <p>2. The Head Reporting Foreign Pension Division shall report to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Foreign Pension Division shall be eleven (11).</p>	<p>1.9. Vrši proveru i obezbeđuje ujednačavanje penzijskog radnog staža, za kosovske osiguranike koji su radili u inostranstvu i za strance koji su radili na Kosovu;</p> <p>1.10. Razvija procedure koje se odnose na povraćaj preplaćenih i penzijskih naknada; i</p> <p>1.11. Pokreće postupke za ostvarivanje prava na penziju utvrđene zakonodavstvom na snazi, u skladu sa bilateralnim i multilateralnim sporazumima o socijalnom osiguranju.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za inostrane penzije, izveštava direktoru Odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za inostrane penzije je jedanaest (11).</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 55</b> <b>Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale</b></p>	<p align="center"><b>Article 55</b> <b>Pension Scheme Administration Division</b></p>	<p align="center"><b>Član 55</b> <b>Odsek za upravljanje penzijskim šemama</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale, janë:</p> <p>1.1. Administron të gjitha skemat pensionale në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.2. Administron, menaxhon dhe koordinon aktivitetet me Zyrat e Pensioneve, si degë lokale të Ministrisë;</p> <p>1.3. Menaxhon dhe mirëmban regjistrat e pagesave të skemave pensionale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.4. Siguron hapjen e llogarive bankare për përfituesit e skemave pensionale;</p> <p>1.5. Siguron zbatimin e marrëveshjeve dhe kontratave me bankat komerciale apo institucionet e tjera mikrofinanciare, për realizimin e pagesave të pensioneve;</p>	<p>1. The duties and responsibilities of the Pension Scheme Administration Division shall be:</p> <p>1.1. Administering all pension schemes under applicable law;</p> <p>1.2. Administering, managing and coordinating the activities with the Pension Offices, as local branches of the Ministry;</p> <p>1.3. Managing and maintaining the pension scheme payment registers under the applicable legislation;</p> <p>1.4. Ensuring the opening of bank accounts for the pension scheme beneficiaries;</p> <p>1.5. Ensuring the implementation of agreements and contracts with commercial banks or other microfinance institutions on the execution of pension payments;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za upravljanje penzijskim šemama:</p> <p>1.1. Upravlja svim penzijskim šemama u skladu sa zakonodavstvom na snazi;</p> <p>1.2. Upravlja, rukovodi i koordinira aktivnosti sa Kancelarijama za penzije, kao lokalni ogranci ministarstva;</p> <p>1.3. Upravlja i održava registre isplata penzijskih šema, u skladu sa zakonodavstvom na snazi;</p> <p>1.4. Obezbeđuje otvaranje bankovnih računa za korisnike penzijskih šema;</p> <p>1.5. Obezbeđuje sprovođenje sporazuma i ugovora sa poslovnim bankama ili drugim mikrofinansijskim institucijama, za realizaciju isplata penzija;</p>

<p>1.6. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e procedurave administrative për aplikim dhe realizim të së drejtës për pension; dhe</p> <p>1.7. Identifikon dhe përgatit kërkesat për kthimin e pagesave të tepërta apo të mangëta.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Skemave Pensionale, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administrimin e Skemave Pensionale, është dhjetë (10).</p>	<p>1.6. Proposing, drafting and ensuring the implementation of administrative procedures for application and realization of the right to a pension; and</p> <p>1.7. Identifying and preparing requests for the return of overpayment or deficient payment.</p> <p>2. The Head of the Pension Scheme Administration Division shall report to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Pension Scheme Administration Division shall be ten (10).</p>	<p>1.6. Predlaže, izrađuje i obezbeđuje sprovođenje upravnih postupaka radi prijave i ostvarivanja prava na penziju; i</p> <p>1.7. Identifikuje i priprema zahteve za povraćaj više ili manje isplaćenih penzija;</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za upravljanje penzijskim šemama izveštava direktoru odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za upravljanje penzijskim šemama je deset (10).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 56</b> <b>Divizioni për Administrimin e Skemave Pensionale për Kategoritë e Luftës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 56</b> <b>Division for the Administration of Pension Schemes for the War Categories</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 56</b> <b>Odsek za upravljanje penzionim šemama za ratne kategorije</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Administrimin e Skemave Pensionale për Kategoritë e Luftës, janë:</p> <p>1.1. Siguron zbatimin e politikave/strategjive nga fusha e</p>	<p>1. The duties and responsibilities of the Division for the Administration of Pension Schemes for the War Categories are:</p> <p>1.1. Ensures the implementation of policies/strategies in the field of</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za upravljanje penzionim šemama za ratne kategorije:</p> <p>1.1. Osigurava sprovođenje politika/strategija iz oblasti penzija i</p>

<p>pensioneve dhe beneficioneve për kategoritë e dala nga lufta;</p> <p>1.2. siguron zbatimin e legjislacionit nga fusha e pensioneve dhe beneficioneve për kategoritë e dala nga lufta;</p> <p>1.3. Koordinon punën me zyrtarët e pensioneve në nivel lokal, për zbatimin dhe realizimin e detyrave nga fusha e pensioneve dhe beneficioneve për kategoritë e dala nga lufta;</p> <p>1.4. Administron skemat pensionale për kategoritë e luftës;</p> <p>1.5. Mbështet punën e komisioneve mjekësore për vlerësimin e invaliditetit të invalidëve të luftës;</p> <p>1.6. Kompletion dhe mirëmban evidencën për të gjithë shfrytëzuesit e të drejtave në skemën pensionale për kategoritë e dala nga lufta;</p> <p>1.7. Bashkëpunon me strukturat e tjera brenda Ministrisë për realizimin e planeve të punës; dhe</p>	<p>pensions and benefits for the categories left by the war;</p> <p>1.2. Proposes and ensures the implementation of legislation in the field of pensions and benefits for the war categories;</p> <p>1.3. Coordinates the work with pension officials at the local level, for the implementation and realization of tasks in the field of pensions and benefits for the war categories;</p> <p>1.4. Administers pension schemes for war categories;</p> <p>1.5. Supports the work of medical commissions for the assessment of invalidity of war invalids;</p> <p>1.6. Compiles and maintains the evidence for all beneficiaries of the rights in the pension scheme for the categories emerging from the war;</p> <p>1.7. Cooperates with other structures within the Ministry for the realization of work plans; and</p>	<p>beneficija za kategorije koje su proistekle iz rata;</p> <p>1.2. Predlaže i obezbeđuje primenu zakonodavstva iz oblasti penzija i beneficija za kategorije proistekle iz rata;</p> <p>1.3. Koordinira rad sa penzionerima na lokalnom nivou, za primenu i sprovođenje zadataka iz oblasti penzija i beneficija za kategorije proistekle iz rata;</p> <p>1.4. Upravlja penzijskim šemama za kategorije proistekle iz rata;</p> <p>1.5. Podržava rad lekarskih komisija za procenu invalidnosti ratnih vojnih invalida;</p> <p>1.6. Sastavlja i vodi evidenciju za sve korisnike prava penzijske šeme za kategorije proistekle iz rata;</p> <p>1.7. Saraduje sa drugim strukturama u okviru Ministarstva na realizaciji planova rada; i</p>
---	--	--



<p>1.8. Përcakton dhe zhvillon procedurat administrative për aplikimin dhe realizimin e të drejtës për pension të kategorive të luftës.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Skemave për Kategoritë e Luftës, raporton te Drejtori i Departamentit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administrimin e Skemave Pensionale për Kategoritë e Luftës, është trembëdhjetë (13).</p>	<p>1.8. Defines and develops administrative procedures for the application and realization of the right to pension of war categories.</p> <p>2. The Head of the Division for Administration of Schemes for War Categories reports to the Director of the Department.</p> <p>3. The number of employees in the Division for the Administration of Pension Schemes for the War Categories is thirteen (13).</p>	<p>1.8. Definiše i razvija upravne postupke za prijavu i ostvarivanje prava na penziju ratnih kategorija.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za upravljanje penzionim šemama za ratne kategorije, izveštava direktoru Odeljenja.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za upravljanje penzijskim šemama za ratne kategorije, je trinaest (13).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 57</b> <b>Departamenti Ligjor</b></p> <p>1. Departamenti Ligjor ka për mision koordinimin e procesit të shndërrimit të politikave të Ministrisë në akte normative, në përputhje me rendin juridiko-kushtetues, Acquis të Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e mbështetjes ligjore për proceset e ndryshme të Ministrisë.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit Ligjor, janë:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 57</b> <b>Legal Department</b></p> <p>1. The mission of the Legal Department shall be to coordinate the process of transforming the policies of the Ministry into normative acts in accordance with the legal-constitutional order, European Union Acquis and international standards, as well as providing legal support for various processes of the Ministry.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Legal Department shall be:</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 57</b> <b>Pravno odeljenje</b></p> <p>1. Misija Odeljenja za pravne poslove je da koordinira proces prevođenja politika ministarstva u normative akte, u skladu sa pravno-ustavnim poretkom, acquis-om Evropske unije i međunarodnim standardima, kao i da pruža pravnu podršku različitim procesima ministarstva.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za pravne poslove su:</p>

<p>2.1. Koordinon dhe merr pjesë në hartimin e akteve normative dhe dokumenteve të politikave nga fushëveprimi i Ministrisë;</p> <p>2.2. Siguron përputhshmërinë e legjislacionit të Ministrisë me Acquis të Bashkimit Evropian;</p> <p>2.3. Siguron përputhshmërinë e legjislacionit të Ministrisë me dispozitat kushtetuese dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë;</p> <p>2.4. Siguron respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjislacionit nga fushëveprimi i Ministrisë;</p> <p>2.5. Shqyrton dhe është përgjegjës për versionet përfundimtare të projekt akteve normative;</p> <p>2.6. Ofron asistencë juridike në procesin e negocimit dhe të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushëveprimin e Ministrisë;</p>	<p>2.1. Coordinating and taking part in the drafting of normative acts and policy documents within the scope of the Ministry;</p> <p>2.2. Ensuring the compatibility of the Ministry's legislation with the European Union Acquis;</p> <p>2.3. Ensures the compliance of the Ministry's legislation with the constitutional provisions and applicable laws in Kosovo;</p> <p>2.4. Ensuring the observance of techniques and standards for drafting legislation within the scope of the Ministry;</p> <p>2.5. Examining and being responsible for the final versions of draft normative acts;</p> <p>2.6. Providing legal assistance in the process of negotiation and ratification of international agreements within the scope of the Ministry;</p>	<p>2.1. Koordinira i učestvuje u izradi normativnih akata i dokumenata politika iz delokruga ministarstva;</p> <p>2.2. Obezbeđuje usklađenost zakonodavstva ministarstva sa Acquisom Evropske unije;</p> <p>2.3. Obezbeđuje usklađenost zakonodavstva ministarstva sa ustavnim odredbama i primenjivim zakonima na Kosovu;</p> <p>2.4. Obezbeđuje poštovanje tehnika i standarda za izradu zakonodavstva iz delokruga ministarstva;</p> <p>2.5. Razmatra i odgovoran je za konačne verzije nacrtu normativnih akata;</p> <p>2.6. Pruža pravnu pomoć u procesu pregovaranja i ratifikacije međunarodnih sporazuma iz delokruga ministarstva;</p>
---	--	---

